

3207 31-08-2020

NP "Trepça" SHA
Mitrovicë

Raport i Audituar Financiar

Për vitin kalendarik që përfundon
me 31 Dhjetor 2019

Përmbajtja

Faqe

Raporti I Auditorit të Pavarur	2-5
Pasqyra e Gjendjes Financiare	6-7
Pasqyra e të Ardhurave	8
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet	9
Pasqyra e Rrjetës së Parasë	10
Shënimë mbi Pasqyrat Financiare	11-19

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e NP “Trepça” Sh.a.

Mohim i Opinionit

Ne ishim të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare të Kopmanisë Publike “Trepça” Sh.a, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit finanziar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e myllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare të Kompanisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkuar në seksionin *Baza për Mohim të Opinionit* të raportit tonë, ne nuk ishim në gjendje të marrim evidenca të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit për të siguruar një bazë për opinion të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Baza për Mohim të Opinionit

Ne Pasqyrat financiare për vitin 2019 të Shoqërisë Aksionare “Trepca” nuk janë përfshirë ne terësi gjendjet pozicionit financier për të gjitha njesitë e saj organizative (pasuritë, detyrimet etj.). Gjendja financiare për njesinë biznesore sipas pikes 2.3 të nenin 2 të Ligjit për Trepçen Nr.05/L-120, Miniera me Flotacion Kopaonik – Leposaviç (Fi 804/89) nuk është perfshirë fare as per ketë periudhë.

Ne nuk kemi pasur qasje ne dokumentacionin financier të njesisë së cekur ne paragrafin paraprak, përfshirë dokumentacionin e auditimit të auditorëve të njesisë ne fjalë. Si rezultat, ne nuk ishim në gjendje të përcaktionim nëse ndonjë rregullim ishte i nevojshëm për sa i përket pjesës proporcionale të Grupit në pasuritë të Sh.a Trepça që kontrollohen bashkërisht, pjesën e tij proporcionale të detyrimeve të Kompanisë për të cilat kanë përgjegjësi të përbashkët, pjesën e tij proporcionale të të ardhurave dhe shpenzimet për vitin, dhe elementet që përbëjnë pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhjes së parasë.

Theksim i çështjes

Ne pamundesi të rregullimit nga ana e menaxhmenti të disa çështjve me rendësi që lidhen me Pasqyrat financiare të periudhës do ti shpalosim si çështje të theksuara si ne vijim:

- a) Theksimi i auditorit se Saldot fillestare te vitit aktual të aseteve nuk perputhen me gjendjet me 31.12.2018 sipas Raportit të Auditorit per vitin 2018.

Ne Bilancin e gjëndjes është prezentuar një irritje e vleres neto te Prones, pajisjeve dhe impianteve nga viti 2018 ne vitin 2019 prej 138.193.787 euro (150.528.980-12.335.139), ku realisht sipas listave te Aseteve Fikse me zhvleresim te Kompanisë gjatë vitit 2019 ka pas blerje ne vlerë prej 751.456 euro dhe investime ne vijim prej 99.999 euro ne total 851.455 euro.

Arsyetimi i Menaxhmentit te kompanisë per keto diferenca ishte qe asetet e vitit 2018 kane qene te regjistruara gabimisht ne vlerë prej : 12.335.193€ kurse ne vitin 2019 asetet jane regjistruar konform punes se komisioneve per gjegjese ne vlerë prej 150.528.980 .

Arsyetimi i klientit është se korrigimi i pasurisë eshte konform rekomandimeve te Auditorit te Jashtem nga raporti i vitit 2018 i cili ka rekonduar korigimin e aseteve nga viti 2018. Në Planin e biznesit për vitin 2020 janë planifikuar mjete financiare për rivlerësimin e aseteve nga kompanite e licencuara.

- b) Theksimi i auditorit sa i përket programit te kontabilitetit nuk kemi siguri me faktin qe nuk e gjeneron Librin kryesor , aty zakonisht regjistrohen të gjitha transacionet financiare të periudhës. Ky poashthu nuk gjeneron Ditarin financier dhe bruto bilancin conform Standardeve te kontabiliteti.

Arsyetimi i klientit :Menaxhmenti i Trepça Sh.A. per vitin 2020 ka planifikuar furnizimin me souftver të kontabilitetit.

- c) Theksimi i auditorit se kompania nuk posedon politika kontabel dhe nje rregullore ne lidhje me kalkulimin e vjetësise te llogarive te arketueshme dhe nje kontrolle me te mire ndaj kerkesave dhe te beje analiza te rregulla te vjetësise se llogarive te aketueshme qe do ti ndihmoje menaxhmentit qe te permiresoj arketimet dhe barazimet me klientet dhe te beje vleresime te sakta per provizione te borxheve te keqja ashtu siç kërkohet me Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar (SNRF).

Arsyetimi i klientit është se kompania i ka proceduar tek permbaruesi privat dhe në Gjykatat Kompetente.Llogaritë e Arkëtueshme në vonesë.

- d) Theksimi i auditorit lidhur me Kapitalin aksionar per vitin 2019 as per vitin paraprak nuk ka një prezentim dhe shpalosje konsistente ashtu siç kërkohet me Standarde . Deri sa ne vitin 2018 si kapita aksionar eshte paraqit shuma prej 22.808.174 euro ne vitin 2019 si kapital ne pasqyra Financiare eshte paraqit ne shume prej 163.058.866€ dmth me një diferencë prej 140.250.692.00€.

Arsyetimi i klientit lidhur me Kapitalin aksionar për vitin 2019 është shpalosur dhe shihet se eshte rritur si pasoj e rivlerësimit te aseteve sipas komisioneve per regjistrim. gjë që ishte e rekonduar në pasqyrat financiare të audituara nga Auditori Ligjor per vitin 2018.

- e) Theksimi i auditorit qe lidhejt me shpenzimet per pagat ne Pasqyren e të ardhurave për vitin aktual Jane prezentu ne shumë prej 12.313.654.00 euro , ndersa sipas Deklaratave per tatimin e mbajtur ne burim janë deklaru ne vlerë prej 19.063.507.24 euro , me një diferencë prej 6.749.853.24 eruo.

Arsyetimi i klientit është se NP Trepça Sh.A. në Pasqyrën e të Ardhurave për vitin 2019 ka prezentuar gjendjen faktike te pagave, diferenca e paraqitur rrjedh nga Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç, njësi e cila eshte ne pronesi te Trepça SH.A sipas Ligjit për Trepçen Nr.05/L-120, mirëpo nuk respekton ligjin në fjalë.

- f) Theksimi i auditorit lidhur me pozicionin e te hyrave ku sipas Pasqyrave Financiare te Ardhurave per vitin 2019 shuma prej 14.424.339.00 euro , ndersa sipas deklaratave te tvsh si realizim eshtë prezentuar shuma prej 22.791.410.90 euro , dmth me një diferencë prej 8.367.071.90 euro
Sipas informacioneve të zyrtarve të kompanisë kjo eshtë si pasojë e mos inkorporimit të asnje informate financiare qe lidhet me pasqyrat nga pjesa e njesise se Trepçës që eshtë ne veri.

Arsyetimi i klientit për pozicionin e të hyrave sipas Pasqyrave financiare eshtë pasqyruar gjendja faktike e të ardhurave duke mos pasur mundësi inkuadrimin e të dhënave nga Njesia biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç (Pjesa Veriore e Mitrovicës) , njësi e cila eshte në pronësi të Trepça SH.A sipas Ligjit për Trepçen Nr.05/L-120, mirëpo nuk respekton ligjin në fjalë.

- g) Theksimi i auditorit për shpenzimet e Rentes minerare janë prezentuar dhe shpalosur per vitin 2019 ne shumen prej : 800.268.00 derisa sa per vitin paraprak nuk ka prezentim fare. kjo tregon mosrespektimi I parimit te konsistencies.

Arsyetimi i klientit eshtë se në vitin 2019 Trepça Sh.A. ka shpalosur shpenzimet për Rentën Minerare konform SNK dhe Ligjit për Trepçen Nr.05/L-120 si dhe rekomandimeve të Auditorit Ligjor nga viti paraprak.

- h) Në pasqyrat financiare nuk janë shpalosur të gjitha informacionet e nevojshme në përputhje me kërkesat e SNK-ve dhe SNRF-ve. Nuk janë shpalosur shumica e pozacioneve të Bilancit te Gjendjes si dhe, vlera e drejtë dhe menaxhimi i rrezikut të kapitalit, rrezikut finanziar, rrezikut të tregut, rrezikut kreditor dhe rrezikut të likuiditetit, zotimet dhe kontigjentat si dhe ngjarjet pasuese.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti eshtë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë (SNRF), dhe për kontrolllet e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, eshtë i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti eshtë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur eshtë e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjeter reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Përgjegjësia jonë eshtë të bëjmë një auditim të pasqyrave financiare të Kompanisë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të lëshojmë një raport të auditorit. Sidoqoftë, për shkak të çështjeve të përshkruar në seksionin Baza për Mohim të Opinionit të raportit tonë, ne nuk ishim në gjendje të marrim evidenca të mjaftueshme e të përshtatshme të auditimit për të siguruar një bazë për opinionin e auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative


Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqerisë aksionare Trepça , mirëpo në mungesë të një raporti të menaxhmentit I cili bazohet në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10, ne nuk kishim informacione për dhenien e një opinioni nëse raporti i menaxhmentit është përgatitur në pajtueshmëri më kërkesat e lartëcekura dhe në përputhje me pasqyrat financiare për vitin finanziar raportues.

Raport mbi kërkesat tjera

Ne ishim të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare të Kopmanisë Publike "Trepça" Sh.a, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse duke vlersuar edhe qeshtjet tjera që lidhen me to :

- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'i përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimve shpjeguese.
- Ne konfirmojmë që opinioni i auditimit është në përputhje me raportin shtesë në komitetin e auditimit.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavarsinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;



**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

RAPORTI FINANCIAR VJETOR

Emri i kompanisë: *Trepça SH.A.*

Numri Unik Identifikues: 811278747

Adresa: *Parku Industrial pn Mitrovicë*

Pasqyra e pozitës financiare

më 31 dhjetor 2019

	Shënimi	2019	2018
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3.3	37,236	793,149
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	1,329,188	1,499,657
Stoqet	3.5	1,430,250	738,400
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë		248,222	-
Pasuritë e tjera afatshkurtra	3.4.1		
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		3,044,896	3,031,206
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	3.2	150,528,980	12,335,193
Investimet në vijim	3.2	99,999	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		150,628,979	12,335,193
Gjithsej pasuritë		153,673,875	15,366,399
DETÝRIMET DHE EKUITETI			
DETÝRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	3,625,298	2,344,883
Tatimet e pagueshme aktuale		1,416,031	983,688
Të hyrat e shtyra	3.7.1	866,846	-
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatshkurtër		104,554	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra- Renta Minerare	3.7	797,642	171,446
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		6,810,371	3,500,017

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

Detyrimet afatgjata			
Grantet e Shtyera	3.7	2,012,346	3,799,232
Gjithsej detyrimet afatgjata		2,012,346	3,799,232
Gjithsej detyrimet		8,822,717	7,299,249
EKUITETI			
Kapitali aksionar	3.13	163,058,866	22,808,174
Fitimet (Humbjet) e mbajtura	3.13	-	-
Fitimi (Humbja) i vtit		14,741,024	12,529,886
Gjithsej ekuiteti		3,466,684	2,211,138
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		144,851,158	8,067,150
		153,673,875	15,366,399

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Drejtori finansiar/Kontabilisti i
Certifikuar

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Të hyrat			
Të hyrat nga shitja	13	9,056,244	11,717,793
Të hyrat tjera	13	305,064	407,039
Total		9,361,308	12,142,832
Shpenzimet			
Shpenzimet e personelit	15	-12,313,654	-12,405,111
Shpenzimet e materialit dhe lëndës së parë	16	-2,992,832	-2,990,991
Shpenzimet e zhvlerësimit	17	-769,654	-543,584
Shpenzimet tjera operative	17	-1,724,026	-1,595,533
Gjithsej shpenzimet		-17,800,166	-17,535,219
Të hyrat financiare nga buxheti i RKS	14	5,063,031	3,271,280
Shpenzimet financiare	18	-90,856	-72,031
Shpenzimet neto financiare		4,972,174	3,199,249
Fitimit para tatimit		-3,466,684	-2,211,138
Shpenzimi i tatimit në fitim		0	0
Fitimi neto përvitin		-3,466,684	-2,211,138
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse			
Totali i të hyrave gjithëpërfshirëse përvitin		-3,466,684	-2,211,138

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Drejtori finansiar/Kontabilisti i
Certifikuar

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2018	22,808,174	- 12,529,886	10,278,288
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	2,211,138	- 2,211,138
Gjendja më 31 dhjetor 2018	22,808,174	- 14,741,024	8,067,150
Gjendja më 1 janar 2019	22,808,174	- 14,741,024	8,067,150
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	3,466,684	- 3,466,684
Deponimet e kapitalit shtesë	140,250,692	-	140,250,692
Gjendja më 31 dhjetor 2019	163,058,866	- 18,207,708	144,851,158

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Drejtori finansiar/Kontabilisti i
Certifikuar

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

**Pasqyra e rrjedhjes së parasë
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	Shënim	2019	2018
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		3,466,684	2,211,138
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	769,654	543,584
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		2,697,030	1,667,554
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative (Rritja) / zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	170,469	2,420,298
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	3.5	691,850	14,737
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshmë tregtare dhe të tjera	3.8	3,310,354	1,814,905
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		91,943	1,047,424
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	755,913	699,627
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		755,913	699,627
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesat e lizingut finanziar		1,786,886	625,566
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		1,786,886	625,566
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	3.3	939,030	1,121,485
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		793,149	1,914,634
		37,236	793,149

Drejtori i përgjithshëm/ekzekutiv

Drejtori finansiar/Kontabilist i Certifikuar

1. Informata të përgjithshme

NP "TREPÇA" SH.A. është një shoqëri aksionare e regjistruar në Kosovë. Adresa e regjistruar e zyrës dhe vendi bazë i afarizmit është në Mitrovicë, Trepça Parku Industrial Mitrovicë, p.n.. Aktiviteti i kryesor i NP "TREPÇA" SH.A. është Nxjerrja e xeheve të tjera jo-hekuri. Në periudhën e fundit Trepça SHA kishte 1,217 punëtor.

Pronar/ Aksionarë

Qeveria e Republikës së Kosoves	8,000€	80%
Punëtorët e Trepçës	2,000€	20%

NJËSITË

1. 5237742 MINIERAT ME FLOTACION TREPÇA - STAN TËRG MITROVICË, STANTËRG
2. 5237769 MINIERAT ME FLOTACION KISHNICË DHE ARTANË GRAÇANICË, GRAÇANICË
3. 5237777 MINIERAT ME FLOTACION KOPAONIK - LEPOSAVIÇ MITROVICË VERIORE, MITROVICË VERIORE
4. 5237785 METALURGJIA E PLUMBIT MITROVICË VERIORE, MITROVICË VERIORE
5. 5237793 METALURGJIA E ZINKUT MITROVICË, MITROVICË
6. 5237807 INDUSTRIA KIMIKE MITROVICË, MITROVICË
7. 5237815 FABRIKA E AKUMULATORËVE NË MITROVICË, MITROVICË
8. 5237823 FABRIKA E PAJIMEVE TË PROCESIT MITROVICË, MITROVICË
9. 5237831 STABILIMENTET ENERGJETIKE (ENERGJETIKA) MITROVICË, MITROVICË
10. 5237858 LABORATORI NË ZVEÇAN MITROVICË VERIORE, MITROVICË VERIORE
11. 5237866 INSTITUTI I PLUMBIT DHE ZINKUT MITROVICË, MITROVICË
12. 5237874 KOMPLEKSI ADMINISTRATIV I KISHNICËS NË PRISHTINË PRISHTINË, PRISHTINË
13. 5237882 KOMPLEKSI ADMINISTRATIV NË ZVEÇAN MITROVICË VERIORE, MITROVICË VERIORE

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE ATYRE TË RISHIKUARA PËR RAPORTIM FINANCIAR

2.1 Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën e raportuar

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare janë në fuqi për periudhën reportuese (efektiv për periudha vjetore që fillojnë më apo pas datës 1 janar 2019):

• Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet Financiare

Më 12 tetor 2017, BSNK publikoi 'Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshime në SNRF 9)' për të adresuar shqetësimet rreth asaj se si SNRF 9 'Instrumentet Financiare' klasifikon aktivet financiare të veçanta të parapagueshme. Përveç kësaj, BSNK sqaroi një aspekt të kontabilitetit për pasivet financiare pas një modifikimi. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive për vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

• KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Taksave mbi të Ardhurat

KIRFN 23 është lëshuar nga BSNK më 7 qershori 2017 dhe është efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, me leje të lejuara më parë.

• SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 ofron një model gjithëpërfshirës për identifikimin e marrëveshjeve të qirasë dhe trajtimin e tyre në pasqyrat financiare për të dy qiramarrësit dhe qiradhënsit. SNRF 16 do të zëvendësojë udhëzimet aktuale të qirasë duke përfshirë SNK 17 Qiratë dhe interpretimet përkatëse kur të hyjë në fuqi për periudhat kontabël që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019.

• Ndryshime në SNK 28 Interesat Afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta

Më 12 tetor 2017, BSNK publikoi "Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)" për të sqaruar se një njësi ekonomike zbaton SNRF 9 "Instrumentet Financiare" për interesat afatgjatë në një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët që formon pjesë e investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, por për të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive për vitet fiskale që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

• Ndryshime në SNK 19 Përfitimet e punonjësve Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja

Më 7 shkurt 2018, BSNK publikoi 'Ndryshimin e Planit, Reduktimin ose Zgjidhjen (Ndryshimet në SNK 19)' për të harmonizuar praktikat kontabël dhe për të dhënë informacion më të rëndësishëm për vendimmarrje. Një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për ndryshimet në plan, reduktimi ose zgjidhja që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019.

2.2 Standardet dhe interpretimet në fjalë nuk janë ende efektive

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare të veçanta standardet, përmirësimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma në fuqi.

- **Ndryshimet në fazën e pare të reformës në Librin e Regjistrimëve të Investimeve (IBOR)**
Më 26 Shtator 2019, BSNK lëshoi 'Reformën në Standardin e Normave të Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7)' si një reagim i parë ndaj efekteve të mundshme që reforma IBOR mund të ketë në raportimin financiar. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2020.
- **Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit**
Më 22 tetor 2018, BSNK lëshoi 'Përcaktimi i një biznesi (Ndryshime në SNRF 3)' që synojnë zgjidhjen e vështirësive që shfaqen kur një entitet përcakton nëse ka siguruar një biznes apo një grup të pasurive. Ndryshimet janë efektive për kombinimet e biznesit për të cilat data e përvetësimit është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 Janarit 2020.
- **Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 Përkufizimi I Ri I Materialitetit**
Më 31 tetor 2018, BSNK lëshoi 'Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)' për të sqaruar përkufizimin e 'materialit' dhe për të lidhur përkufizimin e përdorur në Kornizën Konceptuale dhe vetë standardet. Ndryshimet janë efektive për periudha të raportimit vjetor që fillojnë në ose pas 1 janarit 2020.
- **Referencat e Perditësuara në Kornizen Konceptuale**
Së bashku me 'Kornizën Konceptuale' të rishikuar të publikuar në Mars 2018, BSNK lëshoi gjithashtu 'Ndryshime në Referencia të Kornizës Konceptuale në Standardet e SNRF'. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2020.
- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimit**
SNRF 17 kërkon që detyrimet e sigurimit të maten me një vlerë aktuale të përbushjes dhe të sigurojnë një qasje më të njëtërajtshme të matjes dhe prezantimit për të gjitha kontratat e sigurimit. Këto kërkesa janë të dizajnuara për të arritur qëllimin e kontabilitetit konstant të bazuar në parime për kontratat e sigurimit. SNRF 17 zëvendëson SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve që nga 1 Janari 2021.
- **Ndryshimet në SNK 1 Klasifikimin e Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale**
Më 23 Janar 2020, BSNK lëshoi 'Klasifikimin e Detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshimet në SNK 1)' duke siguruar një qasje më të përgjithshme për klasifikimin e detyrimeve sipas SNK 1 bazuar në marrëveshjet kontraktuale në vend në datën e raportimit. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretime ekzistuese nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Kompanisë.

**3 . PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
dhe Shpalosja e Pasqyrave Financiare per vitin 2019**

3.1 Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtim me Standarde Ndërkombëtare për Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Baza e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në baza historike të kostos përveç rivlerësimit të pasurisë së caktuar për asete dhe detyrime të caktuara që janë vlerësuar me vlerën reale.

Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë paraqitur në njësi monetare Euro (€), cila është edhe monedha funksionale për Kompaninë. Euro (€) është valutë kombëtare në Kosovë.

3.2 Prona, impiantet dhe pajisjet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të përashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normal vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Ndërtesar 5%

Pajisjet, mjetet transportuese, inventari 20%

Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatesisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup paşurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merrret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në mënyrë të ngjashme, në çdo datë të raportimit, stoqët vlerësohen për rënie të vlerës duke krahasuar vlerën kontabël neto të çdo artikulli të stoqeve (ose grüp të artikujve të ngjashëm) me çmimin e tij të shitjes minus kostot e shitjes. Nëse një artikull i stoqeve (ose grupei i artikujve të ngjashme) është i dëmtuar, vlera e tij kontabël reduktohet për çmimin shitës minus kostot e shitjes, dhe humbja nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA “Trepça”, përvitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) më pas kthehet, vlera kontabël e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet përvlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikuperueshme (çmimi shitës minus kostot e e shitjes, në rastin e stoqeve), por jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do ishte njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë përvpasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

3.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë të holla në bankë dhe në dorë. Për qellime të rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë para në dorë dhe të parave të gatshme të mbajtura në bankat, duke përfshirë depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

3.4 Të arkëtueshme dhe kerkesat tjera tregtare

Të arkëtueshmet tregtare janë regjistruar fillimi me shumën e arkëtar kundrejt shitjes së produkteve. Më pas të arkëtueshmet tregtare janë dhënë në koston nominale minus lejimi përborxhet e dyshimta.

3.5 Stoqet

Kostoja e stoqeve përfshinë kostot e ndërlidhura drejtpërdrejt me blerjet, njësitë e shitjeve. Raportimi i stoqeve është bërë me çmimin e kostos.

3.6 Njohja e të Hyrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtar ose të arkëtueshme. Të ardhurat zvogëlohen përkthimet e konsumatorëve, zbritjet dhe lejimet tjera të ngjashme.

3.14 Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të periudhës aktuale dhe të tatimit të shtyrë. Tatimi i periudhës aktuale dhe tatimi i shtyrë njihen në llogaritë e fitimit (humbjes), përvèc pjeses që lidhët me elementët që njihen drejtpersëdrejti në llogarinë e kapitalit ose në të tjera të ardhura permblledhëse.

3.14.1 Tatimi i periudhes aktuale

Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatushëm të vitit.

3.14.2 Tatimi i shtyrë njihet nga diferençat ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferençat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen përvës gjitha diferençat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatushëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen përvës gjitha diferençat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatushëm në të ardhmen dhe çdo humbje tatimore ose kreditim tatimor të papërdorur. Pasuritë e shtyra tatimore maten me shumën më të lartë që, në bazë të fitimit të tatushëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar, ka më shumë gjasa që të rimerret sesa që të mos rimerret.

Vlera kontabël neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit dhe rregullohet përvës pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatushme në të ardhmen. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

3.7 Detyrimet

Një detyrim njihet në goftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Kompanisë i lindin detyrime ligjore ose konstruktive të cilat mund të parashikohen me besueshmëri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit.

3.8 Llogarit e pagueshme

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

Llogarit e Pagueshme njihen kur shuma është e përcaktueshme dhe obligimi për te paguar këtë shume ekziston si rezultat i veprimtarive ekonomike. Ato paraqiten sipas kostos.

3.7 Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

3.10 Shpenzimet e periudhës

Shpenzimet janë njojur ne momentin e ndodhjes

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në Pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve në datën e kryerjes së shërbimit, marrjes së përfitimit ose në datën e origjinës.

Kostot e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

3.2 Makineritë dhe pajisjet

Kostoja	Toka	Ndërtesat	Pajisje Prodhuese	Pajisje Transportuese	Pajisje zyre, Inventari	Puna në proces	Gjithsej
	€	€	€	€	€	€	€
Më 1 janar 2019	148,343,937	372,731	14,797,815	963,965	53,600	-	164,532,047
Shtesat gjatë vitit	-	-	744,064	-	7,391	99,999	851,455
Më 31 dhjetor 2019	148,343,937	372,731	15,541,879	963,965	60,991	99,999	165,383,502
Zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi							
Më 1 janar 2019	-	223,518	12,784,176	952,249	24,796	-	13,984,740
Zhvlerësimi vjetor	-	18,637	727,920	11,716	11,511	-	769,783
Më 31 dhjetor 2019	-	242,155	13,512,096	963,965	36,307	-	14,754,523
Vlera neto							
Më 31 dhjetor 2019	148,343,937	130,576	2,029,783	-	24,684	99,999	150,628,979

13. Të hyrat

Të hyrat përbëhen si në vijim:

a) **Të hyrat nga shitjet**

Përshkrimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Të hyrat nga shitja e koncentratit të zinkut	3,412,933	3,431,585
Të hyrat nga shitja e koncentratit të Plumbit	5,393,929	6,129,329
Të hyrat nga shitja e aluminium sulfatit	102,323	172,050
Të hyrat nga shitja e imbeturinave	147,059	1,984,829
Gjithsej të hyrat nga shitjet	9,056,244	11,717,793

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

b) Të hyrat tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Përshkrimi		
Të hyrat nga shërbimet për palët e treta	13,839	19,447
Të hyrat nga qiraja	291,225	387,592
Gjithsejt të hyrat tjera	305,064	407,039
Gjithsej të hyrat (a+b)	9,361,308	12,124,832

14. Të hyrat tjera financiare

Të hyrat përbëhen si në vijim:

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Përshkrimi		
Subvencione për paga dhe stipendione nga Buxheti i RKS	3,782,870	2,158,009
Investime kapitale nga Buxheti i RKS	1,269,832	1,051,034
Fitimet nga këmbimet valutore	10,329	62,237
Gjithsejt të hyrat tjera financiare	5,063,031	3,271,280

15. Shpenzimet e Personelit

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Përshkrimi		
Pagat dhe shtesat në pagë	11,697,971	11,814,966
Kontributet pensionale	615,683	590,145
Gjithsejt	12,313,654	12,405,111

16. Shpenzimet e materialit dhe lëndës së parë

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Përshkrimi		
Shpenzime të materialit dhe lëndës së parë	794,935	

**Pasqyrat Financiare, politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të SHA "Trepça",
për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019**

Vegla, paisje të imta, pjesë rezervë	583,216
Autogoma në përdorim për makina produktive	44,223
Shpenzimet e materialit për mirëmbajtje dhe riparim	33,584
Shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	22,289
Shpenzimet e energjisë elektrike	1,510,586
Gjithsejt	2,992,832

17. Shpenzimet tjera Operative

Përshkrimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Mirëmbajtje dhe riparime	3,403	137,218
Shpenzime tjera administrative	128,854	213,702
Shpenzimet e transportit	214,323	229,372
Shpenzimet për rentën minerare	800,268	
Shpenzimet e zhvlerësimit	769,654	
Shpenzimet e ushqimit të punëtorëve	368,857	456,139
Komunalit		
Shpenzimet e ujit	---	177,870
Shpenzimet e telefonisë dhe internetit	147,329	
Shpenzimet për mbeturina	21,272	
Shpenzimet tjera publike	8,219	
Shpenzimet tjera	1,843	
Gjithsej	2,493,680	381,232
		1,595,533

18. Shpenzimet financiare

Përshkrimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018
Shpenzimet financiare		
Humbjet nga diferenca negative e kursit të këmbimit	7,457	72,031
Shpenzime të interesit	43,785	
Shpenzime të jashtëzakonshme	39,614	
Gjithsejt	90,856	72,031

Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me date 30.04.2020.